

V E N D I M
PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot, më datë 16.10 1999 (nëntëdhjet e nëntë), unë gjyqtari Mirë Çepi pranë Gjykatës së rrethit Tiranë, shqyrtova kërkesën e paraqitur nga kërkuessit **Flamur Xhemali** dhe **Arben Fejzo**, për regjistrimin pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, në regjistrin tregtar, të Shoqërisë "**ALBA**" Sh.a. si person juridik.

KONSTATOVA:

Se, kërkuessit, **Flamur Xhemali** dhe **Arben Fejzo** kërkojnë regjistrimin si person juridik të Shoqërisë "**ALBA**" Sh.a. të krijuar prej tij me kushtet e mëposhtme:

- Emërtimi i shoqërisë është "**ALBA**" Sh.a. Tiranë.
- President i shoqërisë do të jetë Zoti **Flamur Xhemali**.
- Drejtor i Shoqërisë do të jetë Zoti **Mersin Gjini**.
- Ekspert kontabël i miratuar do të jetë Zoti **Kristaq Çombi**.
- Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga M. Peza, Pall. 200, Shk. 2, Ap. 12.
- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Eksport - import, përpunimin, transportimin dhe tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 (dymilion) lekë dhe është i ndarë në 200 aksione me vlerë nominale secili aksion nga 10.000 lekë. Kapitali zotërohet nga aksionerët si më poshtë:

1. Flamur Xhemali zotëron 140 aksione = 1.400.000 lekë ose 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Arben Fejzo zotëron 60 aksione = 600.000 lekë ose 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Shoqëria private do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 20 vjet. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Tiranë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

Për këto arsye

Në bazë të ligjit Nr. 7638, datë 19. 11. 1992

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin si person juridik të Shoqërisë me kushtet e mëposhtme.

- Emërtimi i shoqërisë është "**ALBA**" SH.A.
- President i shoqërisë është Zoti **Flamur Xhemali**.
- Drejtor i shoqërisë është zoti **Mersin Gjini**.
- Ekspert kontabël i miratuar është Zoti **Kristaq Çombi**.
- Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga M. Peza, Pall. 200, Shk. 2, Ap. 12.
- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: Eksport - import, përpunimin, transportimin dhe tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre.

• Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 (dymilion) lekë dhe është i ndarë në 200 aksione me vlerë nominale secili aksion nga 10.000 lekë. Kapitali zotërohet nga aksionerët si më poshtë:

1. Flamur Xhemali zotëron 140 aksione = 1.400.000 lekë ose 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Arben Fejzo zotëron 60 aksione = 600.000 lekë ose 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

• Shoqëria private do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 20 vjet. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Tiranë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Shkallës së Dytë.

Tiranë, më 26.10. 1999

GJYQTAR
Arben Fejzo
EF

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr 2178/ VENDIMIT

VENDIM
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me 10/07/ 2002, Une gjyqetarja e vetme Regleta PANAJOTI, prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane pasi shqyrtova kerkesen Drejtorit Mersin GJINI dhe dokumentat e shoqerise anonime "ALBA" sh.a.

KONSTATOVA

Se kerkuesi ka paraqitur para gjykates Vendimin e Asamblese se Aksionereve te dt.03.07.2002, te shoqerise "ALBA"sh.a dhe Kontraten e Shitjes se Askioneve Nr 2459/116 dt.03.07 2002 duke parashtuar sa me poshte

Aksioneret e shoqerise Z.Flamur XHEMALI dhe Z.Arben FEJZO me vendimin e tyre te dt.03.07.2002 kane vendosur :

Se Pari . Shitjen e aksioneve te Z.Arben Fejzo tek Z.Flamur Xhemlai . Kjo shitje u krye me anen e kontrates se shtijeve te aksioneve Nr.2459/116 dt.03.07.2002 . Me anen e kesaj kontrate aksioneri tjeter Z.Arben FEJZO i ka shitur aksionet e tij ,ne vleren 30 % te kapitalit themeltar ose 60 aksione, duke u larguar keshtu nga shoqeria.

Se dyti. Ekspert kontabel i autorizuar do te jete:

Kastrot HAXHAJ

Se treti. Shtimin e objektit te veprimatrise se shoqerise:

Shoqeria pervec sa parashikuar ne statut do te prodhoje ,ambalazhoje dhe tregetoje dhe vajin lubrifikant, grason, antifrizen, ujin e distiluar etj.

Ne perfundim te shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur duke e konsideruar kerkesen e bere te drejte dhe si te tille duhet pranuar

PER KETO ARSYE

2002



Ne baze te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7667 dt.28.01.1993 " Per Rregjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".


VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Rregjistrimin e ndryshimeve , ne rregjistrin tregetar, sipas Vendimit te Asamblese te Aksionereve te dt.03.07.2002 dhe kontrates se shitjes Nr.2459/116 dt.03.07. 2002, per rregjistrimin si aksioner te vetem te Z.Flamur XHEMALI, rregjistrimin si ekspert kontabel te autorizuar te Z. Kastriot HAXHAJ dhe shtimin e objektit te vepritarise.

Te behen shenimet e duhura ne kolonat 2 dhe 4 te skedes se rregjistrin tregetar dhe te ndahen rregjistrimet nga njera tjera me vije te kuqe.

GJYQETARE
Regleta PANAJOTI



V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 10/10/ 2005 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare
Tirane (G. Pr.) mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi :

- **Mersin GJINI**
per depozitim prane regjistrimit tregtar te vendimit te aksionerit te vetem te shoqerise
tregtare " **A L B A** " sh.a. dhe :

KONSTATOVA

Me vendimin Nr. 22178, date 26.10.1999 eshte regjistruar si person juridik
shoqeria tregtare " **A L B A** " sh.p.k.

Me vendimin Nr. 1 date 15.06.2005 te aksionerit te vetem te kesaj shoqerie eshte
vendosur :

- Shtimi i kapitalit themeltar te shoqerise me kontribute ne natyre.
- Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar z. Bujar OSMANI.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993:

V E N D O S A


Pranimin e kerkeses.

Depozitim prane regjistrimit tregtar te vendimit Nr. 1 date 15.06.2005 te aksionerit
te vetem te shoqerise tregtare " **A L B A** " sh.a. ku eshte vendosur :

- Shtimi i kapitalit themeltar te shoqerise me kontribute ne natyre.
- Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar z. Bujar OSMANI.

Urdherohet zyra e regjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e
shoqerise.

GJYQTARE



V E N D I M

I GJYQOTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 20-10 2005 une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor
Tirane M. Mulla mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi :

- **Mersin GJINI**

per depozitim prane regjistrimit tregtar te vendimit te aksionerit te vetem te shoqerise
tregtare " **A L B A** " sh.a. dhe :

KONSTATOVA

Me vendimin Nr. **22178**, date 26.10.1999 eshte regjistruar si person juridik
shoqeria tregtare " **A L B A** " sh.a.

Me vendimin Nr. **22178/2** date 10.10.2005 eshte vendosur :

- Shtimi i kapitalit themeltar te shoqerise me kontribute ne natyre.
- Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar z. Bujar OSMANI.

Me vendimin Nr. **2** date 12.10.2005 te asamblese se aksionerit te vetem te
shoqerise " **A L B A** " sh.a. eshte vendosur :

- Miratimi i raportit te ekspertit kontabel per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nepermjet
perfshirjes se rezervave dhe fitimeve te akumuluar ne masen 24.000.000 leke,
i cili pas zmadhimit behet ne masen 26.000.000 leke.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr. **7638**, date 19.11.1992, te Ligjit Nr. **7667** date 28.01.1993:

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.


Depozitim prane regjistrimit tregtar te vendimit Nr. **2** date 12.10.2005 te aksionerit
te vetem te shoqerise tregtare " **A L B A** " sh.a. ku eshte vendosur :

- Miratimi i raportit te ekspertit kontabel per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nepermjet
perfshirjes se rezervave dhe fitimeve te akumuluar ne masen 24.000.000 leke,
i cili pas zmadhimit behet ne masen 26.000.000 leke.

Depozitim e raportit te ekspertit kontabel.

Urdhrohet zyra e regjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 2178/6 **VENDIMI**

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 05.03. 2007 Une, M. Ullas gjyqtare e vetme e Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesit Znj. Xhemile Xhemali, ne cilesine e Drejtorit te Shoqerise "ALBA" SH.A. per depozitimin e Vendimeve te Asamblese se Aksionerit te Vetem te kesaj Shoqerie, prane Zyres se Regjistrimit Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "ALBA" Sh.a. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. 22178, date 26.10.1999.

Kapitali i shoqerise "ALBA" Sh.a. zoterohet nga aksioneri i vetem i shoqerise Z. Flamur Xhemali.

Ne mbledhjen e dates 25.06.2006 Aksioneri i vetem i Shoqerise ka vendosur :

- Shtimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet kapitalizimit te fitimit te pashperndare te shoqerise deri me 31.12.2005.
- Caktimin e Z. Bujar Osmani, Ekspert Kontabel i Autorizuar, me license nr. 70, dt. 10.02.2000, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje me dt. 31.12.2005.
- Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ne mbledhjen e dates 23.01.2007 Aksioneri i vetem i shoqerise ka vendosur :

1. Shtimi i objektit te veprimtarise se Shoqerise si me poshte:

Import, eksport e tregtim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit per automjete, materialeve elektrike, si dhe kimikate te te gjitha llojeve.

2. Riemerimin e antareve te Keshillit Mbikqyres te shoqerise:
 - o Flamur Xhemali
 - o Arben Fejzaj
 - o Kastriot Xhemali

Ne mbledhjen e dates 24.01.2007, Keshilli Mbikqyres i shoqerise ka vendosur :

- Emerimin e Z. Flamur Xhemali ne postin e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres.
- Emerimin e Z. Arben Fejzo ne postin e Nenkryetarit te Keshillit Mbikqyres.
- Miratimin per largimin e Z. MERSIN GJINI, nga posti i Drejtorit te shoqerise "ALBA" SH.A.
- Emerimin e Znj. Xhemile Xhemali, e bija e Eminit, lindur me dt. 29.04.1959, lindur ne Elbasan e banuese ne Tirane, mbajtese e pasaportes me nr. Z0538563, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar per tu emeruar ne postin e Drejtorit te shoqerise "ALBA" Sh.A.

PER KETO ARSYE:

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",


V E N D O S A:

- Pranimin e kerkeses;
- Depozitimn ne zyren e Rgjistrin Tregtar te:
 - Vendimit dt. 25.06.2006 dhe Vendimit dt. 23.01.2007 te Aksionerit te Vetem te Shoqerise « ALBA » SH.A ;
 - Vendimit dt. 24.01.2007 te Anetareve te keshillit Mbikqyres te shoqerise.

Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor ne kollonen duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane me 05. 03. 2007.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 22178/15 VENDIMI

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 01.06. 2007 Une, Flamur Xhemali gjyqtare e vetme e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesit Znj. Xhemile Xhemali, ne cilesine e Drejtorit te Shoqerise "ALBA" SH.A. per depozitimin e Vendimeve te Asamblese se Aksionerit te Vetem te kesaj Shoqerie, prane Zyres se Regjistrit Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "ALBA" Sh.a. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. 22178, date 26.10.1999.

Kapitali i shoqerise "ALBA" Sh.a. zoterohet nga aksioneri i vetem i shoqerise Z. Flamur Xhemali.

Ne mbledhjen e dates 28.03.2007, Aksioneri i vetem i Shoqerise ka vendosur :

1. Pranimin dhe miratimin e raportit te eskpertit Z. Bujar OSMANI, per ritjen e kapitalit te shoqerise "Alba" sh.a me vleren 14.000.000 leke
2. Qe nga ky moment kapitali i ri i shoqerise i regjistruar eshte : kapitali i nenshkruar 26.000.000 leke plus kapitalin e shtuar 14.000.000 leke i barabarte me **40 000 000 Leke** (dyzet million Leke), i zoteruar 100% nga Aksioneri I Vetem I shoqerise Z. Flamur Xhemali. Kapitali i nenshkruar prej 40,000,000 leke perbehet nga 4,000 aksione me vlere 10,000 leke secili.
3. Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

PER KETO ARSYE:

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A:

- Pranimin e kerkeses;
- Depozitimn ne zyren e Regjistrir Tregtar te:
 - Vendimit dt. 28.03.2007, te Aksionerit te Vetem te Shoqerise « ALBA » SH.A ;

Urdherimin e zyres se Regjistrir Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor
ne kollonen duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane me 01.06. 2007.

GJYQTARE

Elvana Klumi



Uollin reg. stium

22118

- Gruentium "Alba, S.A.
- Trupitel, 2000.000 lelae.
- Trupelggatje rubi 10 yst.
- Ne objekt : Trup elap., ferpunan
transportum. etj.
- Ne elarover floum vrenuoli oler
Doben Fejje me puvode. Anun Gpi
- Ne elaper ko utobel Juntop
Goula

Statuti

Act Generalium

Acte e vrenuoli

Acte e reg. stium

Српске
Српске
Српске

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ANONIME "ALBA" SH.A.**



Sot më datë 22. 10. 1999 në qytetin e Tiranës zoti Flamur Xhemali, datëlindja 28. 11. 1957, banues në Shhkodër dhe Zoti Arben Fejzo, datëlindja 08. 12. 1955, banues në Tiranë, vendosën të themelojnë një shoqëri anonime në përpúthje me kërkesat e ligjit 7632 dt. 04. 11. 1992 "Për Kodin Tregtar", ligjit 7638 dt. 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare", ligjit 8450 dt. 24. 02. 1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" dhe dispozitat e tjera nënligjore në fuqi me kushtet dhe objektivat e mëposhtme:

Neni 1

Themelohet Shoqëria Anonime e emërtuar "**ALBA**" SH.A. pa ofertë publike.

Neni 2

Shoqëria është person juridik dhe veprimtaria e saj do të zhvillohet në përpúthje me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Selia qendrore e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga M. Peza, Pall. 200, Shk. 2, Ap. 12. Shoqëria mund të hapë filiale e degë të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 4

Shoqëria "**ALBA**" SH.A. ka si objekt:

- Import - eksport, përpunimin, transportimin dhe tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Neni 5

Veprimtaria e Shoqërisë do të zgjatë për një afat mbi 20 vjet. Veprimtaria do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, regjistrimin në organin tatimor dhe marrjes së lejes së tregtimit nga ministria që mbuon fushën e veprimtarisë së saj.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 (dymilion) lekë dhe është i ndarë në 200 aksione me vlerë nominale secili aksion nga 10.000 lekë. Kapitali zotërohet nga aksioneri si më poshtë:

3. Flamur Xhemali zotëron 140 aksione = 1.400.000 lekë = 70% të kapitalit themeltar
4. Arben Fejzo zotëron 60 aksione = 600.000 lekë = 30% të kapitalit themeltar.

Neni 7

Ortakët aksionerë përballojnë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar. Ata mbajnë përgjegjësi për shkeljet e fajshme që i kanë shkaktuar veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë.

Neni 8

Të ardhurat që realizohen prej shoqërisë, pasi të zbriten detyrimet ndaj të tretëve, u përkasin aksionerëve Flamur Xhemali dhe Arben Fejzo sipas kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 9

Afati i veprimtarisë është i pacaktuar, por gjithsesi mbi 20 vjet. Aksionerët mund të vendosin për shkurtimin e afatit të veprimtarisë ose mund të heqin dorë sipas kushteve të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë që shoqëron këtë Akt themelimi. Veprimtaria e Shoqërisë mbaron edhe kur nuk fiton, nuk rifiton apo humbet të drejtën e liçensimit.

Neni 10

Detyrimet kryesore të ortakëve aksionerë janë:

- Regjistrimi dhe marrja e liçensës për fillimin e aktivitetit.
- Sigurimi i pajisjeve për kapacitetin minimal të fillimin e aktivitetit të shoqërisë.
- Sigurimi i specialistëve dhe personelit të përshtatshëm drejtues administrativ.
- Nënshkrimi i kapitalit fillestar të shoqërisë.

Neni 11

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja (e zakonshme ose e jashtëzakonshme) e ortakëve (aksionerëve).
- Këshilli mbikqyrës. Këshilli i parë mbikqyrës përbëhet nga Flamur Xhemali (Kryetar), Arben Fejzo (Nënkryetar) dhe Kastriot Xhemali (anëtar).
- Drejtori. Drejtor i shoqërisë është Zoti Mersin Gjini.
- Për kontrollin e të ushtruarit ligjor të aktivitetit të shoqërisë caktohn ekspert kontabël i autorizuar. Ekspert kontabël i autorizuar është Zoti Kristaq Çombi.

Neni 12.

Aksionerët si dhe të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e krijimit, të veprimtarisë si dhe ato fakte që janë të destinuara të mbeten sekrete të shoqërisë. Ata mbajnë përgjegjësi në rastet kur vërtetohet se i janë shkaktuar dëme shoqërisë. Ata mbajnë përgjegjësi për këto dëme nga mosrespektimi me dashje ose nga pakujdesia i kësaj dispozite.

Neni 13

Mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim midis aksionerëve dhe me të tretët, në të kundërt ato do të zgjidhen nëpërmjet gjykatës. Gjykata kompetente përcaktohet sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile.


Neni 14

Shoqëria do të ketë vulën e saj me emrin "ALBA" dhe gërmat **Sh.A.** që përcaktojnë tipin e shoqërisë.


Ky Akt themelimi, pasi u lexua nga aksionerët, miratohet prej tyre duke u bërë dhe noterizimi i tij.

ORTAKËT (AKSIONERËT) THEMELUES

Flamur Xhemali



Arben Fejzo



**STATUTI
I SHOQËRISË ANONIME "ALBA" SH.A.
ME SELI NË TIRANË**

Në bazë të aktit të themelimit si dhe në bazë të Protokollit të Asamblesë së Aksionerëve të dt. 22. 10. 1999 si dhe në bazë të ligjit nr. 7638 dt. 19. 11. 1992, veprimtaria e shoqërisë "**ALBA**" SH.A. do të organizohet dhe drejtohet sipas normave dhe dispozitave të këtij statuti:

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

NENI 1

Parimet dhe normat e këtij Statuti shprehin vullnetin e plotë dhe të ndërgjegjshëm të aksionerit në bazë të kërkesave të ligjit nr. 7638 dt. 19. 11. 1992. Ato rregullojnë veprimtarinë dhe strukturat e shoqërisë dhe janë taksative për t'u zbatuar.

NENI 2

Për problemet dhe çështjet që nuk mund të gjejnë zgjidhje në këtë Statut, do të zbatohen kërkesat e ligjit nr. 7667 dt. 28. 01. 1993 "Për regjistrin tregtar" dhe të ligjit "Për investimet e huaja" si dhe dispozitat e Kodit Civil Shqiptar.

PERSONALITETI DHE SELIA

NENI 3

Shoqëria "**ALBA**" SH.A është shoqëri aksionere. Ajo është person juridik dhe e ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Është shoqëri anonime pa ofertë publike. Në të gjitha aktet ose dokumentat e shpallura nga shoqëria, të destinuara për të tretët, shënohet emri i shoqërisë, vlera e kapitalit themeltar dhe emrat e anëtarëve të drejtorisë dhe kryetarit të këshillit mbikqyrës.

Veprimtaria e saj i nënshtrohet legjislacionit shqiptar në fuqi si dhe atij të huaj, kur me këtë të fundit janë krijuar marrëdhënie kontraktuale me baza juridike.

NENI 4

Shoqëria "**ALBA**" Sh.a. ka selinë e saj në Tiranë, Rruga M. Peza, Pall. 200, Shk. 2, Ap. 12..

Ajo mund të krijojë seli dhe filiale të tjera si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj brenda ligjeve në fuqi.

NENI 5

Shoqëria "**ALBA**" Sh.a., vepron me anë të strukturave të saj nëpërmjet të cilave shprehet vullneti i shoqërisë duke e kushtëzuar atë për të mbajtur përgjegjësi të plotë juridike ndaj të tretëve.


NENI 6

Shoqëria "**ALBA**" Sh.a. themelohet për të zhvilluar aktivitetin e saj për një afat mbi 20 vjet dhe merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet, qysh nga momenti i regjistrimit dhe themelimit pranë organeve kompetente.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 7

Shoqëria "**ALBA**" Sh.a. ka si objekt: Import eksportin, përpunimin, transportimin dhe tregtimin me shumicë të naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre.



KAPITALI THEMELTAR

NENI 8

Kapitali themeltar është 2.000.000 lekë. Ai është i ndarë në 200 aksione. Vlera nominale e një aksioni është 10.000 lekë.

Kontributi i aksionerëve në kapitalin social është si më poshtë në lekë dhe në %:

1. Flamur Xhemali zotëron 140 aksione ose 70% të kapitalit themeltar.
2. Arneb Fejzo zotëron 60 aksione ose 30% të kapitalit themeltar.

Fitimi neto i shoqërisë do të ndahet në bazë të kuotimit individual social të aksionerëve, pasi të shlyen detyrimet ndërpalëse të cilat trajtohen në një Akt Marrëveshje të veçantë, bashkëngjitur këtij Statuti.

NENI 9

Kapitali duhet të nënshkruhet plotësisht. Shlyerja e vlerës së mbetur bëhet me një ose disa këste, sipas vendimit të drejtorisë.

Aksionet për kontributin në natyrë shlyen plotësisht që në momentin e nënshkrimit.

Aksionet nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime.

NENI 10

Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose mënyra të tjera pagese.

Zmadhimi i kapitalit nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve bëhet vetëm me pëlqimin aksionerëve, me përjashtim të rastit kur ai realizohet në përfshirje të rezervave të fitimeve apo primeve të emetimit.

Zmadhimin e kapitalit themeltar e vendos vetëm mbledhja e asamblesë së jashtëzakonshme.

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet të kryhet brenda 5 vjeteve nga data kur ka vendosur asambleja.

Në rastin e zmadhimit të kapitalit, aksionet janë lirisht të tregtueshme pas realizimit të këtij zmadhimi.

Pas prishjes së shoqërisë (likuidimit) aksionet mbeten lirisht të tregtueshme deri në mbylljen e likuidimit.

NENI 11

Kapitali duhet të jetë shlyer plotësisht para se të jetë bërë emetimi i aksioneve të reja që shlyhen me para në dorë, përndryshe operacioni konsiderohet i pavlefshëm

NENI 12

Aksionet japin të drejtë përparësie në nënshkrim për rritjen e kapitalit. Aksionerët kanë të drejtë përparësie në nënshkrim për rritjen e kapitalit me para në dorë proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron. Ai mund të heqin dorë nga kjo e drejtë vetëm individualisht.

NENI 13

Aksionet për kontributet në natyrë shlyhen plotësisht sapo të emetohen.

NENI 14

Zvogëlimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga asambleja e jashtëzakonshme, e cila mund t'i japë drejtorisë të gjitha të drejtat për ta realizuar.

Në çdo rast, zvogëlimi prek aksionerët në të njëjtëm masë me vlerën e aksioneve që zotërojnë. Zvogëlimi i kapitalit mund të kundërshtohet me gjykatë.

Zvogëlimi i kapitalit, për çfardo shkaku qoftë në një shumë më të vogël se minimumi ligjor, mund të vendoset vetëm me kushtin pezullues të një zmadhimi të kapitalit, i destinuar të çojë këtë të fundit të paktën në minimumin ligjor.

Në rastin e mosrespektimit të kësaj dispozite çdo i interesuar mund të kërkojë nga gjykata kompetente prishjen e shoqërisë. Prishja e shoqërisë nuk mund të shpallet, nëse në ditën kur gjykata shqyrton çështjen, gjendja është rregulluar.

NENI 15

Blerja e aksioneve të veta prej shoqërisë është e ndaluar.

AKSIONET

NENI 16

Aksionet paraqiten detyrimisht në formën e aksioneve normative.

Pronësia e aksioneve rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura prej shoqërisë ose ndërmjetësve financiarë. Ky libër aksionesh do të përmbajë në çdo kohë informatat që përcaktojnë numërin dhe kategorinë e aksioneve, datën e marrjes dhe aksionerin, emrin, mbiemrin dhe adresën e tij si dhe vlerën nominale për çdo aksion të zotëruar.

NENI 17

Aksionerët kanë të drejtën të kërkojnë me shkrim dhe të marrin një ekstrat nga libri i aksioneve, i cili vërtetohet me vulën e shoqërisë. Aksionerët kanë të drejtën të verifikojnë nëse emri i tyre është futur në librin e aksionerëve dhe personi i cili mban librin është i detyruar t'u tregojë aksionerëve, me kërkesën e këtyre të fundit, hyrjen përkatëse në libër.

NENI 18

Në rastin e rritjes së kapitalit themeltar, aksionerët mund të abstenojnë në nënshkrimin e kapitalit të ri, duke ruajtur kuotën e kapitalit të mëparshëm të tyre, ose të tërhiqen nga shoqëria brenda 30 ditëve nga data e vendimit të marrë për rritjen e kapitalit.

Aksionerët pa qenë nevoja e ndonjë vendimi, mund të arkëtojnë në arkën e shoqërisë shuma të konsiderueshme si të nevojshme nga organi administrativ për funksionimin e mirë të shoqërisë dhe kjo propocionalisht me kuotat e kapitalit social dhe pa të drejtë interesi.

Kuotat emërore të kapitalit themeltar janë të trashëgueshme sipas ligjit "Për trashëgiminë" si dhe të kërkesave të nenit 47 "Për shoqëritë tregtare".

NENI 19

Ndryshimi i pronësisë së aksioneve nominative si rrjedhojë e një shitje apo e një transferimi, kryhet ndërmjet një kalimi nga llogaria e dhënësit tek llogaria e marrësit në bazë të një urdhëri xhirimi. Shoqëria është e detyruar të kryejë këtë regjistrim dhe këtë xhirim brenda 6 ditëve nga marrja e urdhër xhirit.

Transferimi i aksioneve falas si rrjedhojë e trashëgimisë kryhet gjithashtu me anën e kalimit në llogari në bazë të një dokumenti ligjor, që vërteton transferimin. Shpenzimet për transferimin e aksioneve janë në ngarkim të blerësit, përveç rastit të një marrëveshjeje të kundërt midis dhënësit e marrësit.



AKSIONERËT NENI 20

Aksioner i shoqërisë është çdo person fizikë ose juridikë vendas ose i huaj që kanë vënë ose do të vënë në zotërim aksione të shoqërisë me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë përmban aderimin në të me të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmjet përfaqësimit në asamblenë e aksionerëve.

NENI 21

Çdo aksioner ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndara nga shoqëria në përputhje me aksionet e veta që zotëron sipas vlerës nominale të zotëruar prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Çdo aksioner ka të drejtë të marrë, kur është rasti, një pjesë nga tepërica e likuidimit të shoqërisë në të njëjtin përpjestim me aksionet e zotëruara.

Aksioneri është vetë përgjegjës për detyrimet dhe humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zotërojnë. Aksioneri ka të drejtën e blerjes dhe të shitjes së aksioneve në bazë të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi.

Të drejtat dhe detyrimet e aksionerit ndjekin aksionin në çfardo forme që ai tjetërsohet tek të tretët.

NENI 22

Aksioneri ka të drejtën e shitjes së aksioneve të shoqërisë tek të tretër, në rast se vendos që shoqëria të jetë me më shumë se një aksioner.

Shoqëria duhet të japë pëlqimin e saj për pranimin e aksionerit të ri, brenda afateve ligjore, në të kundërtën miratimi quhet i dhënë. Çdo kalim i kapitalit, respektivisht i kuotimit social, në kundërshtim me këto norma nuk mund të regjistrohet në librin e shoqërisë.

ORGANET DREJTUESE

NENI 23

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

Asambleja (e zakonshme dhe e jashtëzakonshme) e aksionerëve;

Këshilli mbikqyrës;

Drejtoria.

Në shërbim dhe për kontrollin ligjor të punës së kryer të këtyre organeve caktohen ekspertët kontabël.

ASAMBLEJA

NENI 24

Asambleja e aksionerëve e zakonshme ose e jashtëzakonshme, mund të mbledhet në selinë e vet ose dhe jashtë saj. Asambleja e zakonshme duhet të mbledhet jo më pa se një herë në vit. Asambleja zgjedh presidentin që në këtë rast Aksioneri themelues është edhe president i saj. Në mbledhje thirren herë pas here ekspertët kontabël si dhe shefat përkatës, sipas detyrave të ndara dhe të protokolluara nga Presidenti.

NENI 25

Asambleja kryesohet nga Presidenti.

NENI 26

Mbledhjet e Asamblesë protokollohen.



Për modifikimin e statutit, rritjen apo zvogëlimin e kapitalit social si dhe të numrit të aksionerëve, është e nevojshme vendimi i aksionerit themelues të shoqërisë.

NENI 27

Të gjitha vendimet e Asamblesë firmosen nga presidenti me përjashtim të rasteve kur sipas ligjit duhet të mbahet nga një noter.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 28

Shoqëria drejtohet nga Presidenti Flamur Xhemali, i cili ka mandat kohor të pacaktuar dhe me të drejtë rizgjedhje.

NENI 29

Presidenti ka fuqi të pakufizuar, përsa i përket drejtimit të shoqërisë dhe në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të atyre rasteve kur kompetencat, ligji dhe statuti ia njuh Asamblesë.

NENI 30

Për drejtimin direkt të ekzekutivit Presidenti emëron shefa apo përgjegjësa (me detyra të dubluara) shef menaxhimi, shef transporti dhe konservimi si dhe shef kontabiliteti.

Si për emërimin e shefave dhe të punonjësve të tjerë lidhet kontrata e punës me detyrimet e ndërsjellta e cila detyrimisht firmoset nga Presidenti duke mbajtur në konsideratë dhe respektuar ligjet dhe urdhëresat përkatëse për këtë qëllim nga Qeveria e Shteti.

KËSHILLI MBIKQYRËS

NENI 31

Këshilli mbikqyrës përbëhet nga 3 anëtarë. Asnjë anëtar i keshillit mbikqyrës nuk mund të jetë anëtar i drejtorisë. Anëtarët e parë të keshillit mbikqyrës të caktuar janë:

Flamur Xhemali (Kryetare)
Arben Fejzo (Nën kryetare)
Kastriot Xhemali (Anëtare)

NENI 32

2/3 e anëtarëve të keshillit mbikqyrës emërohen nga mbledhja e asamblesë themeluese ose nga mbledhja e asamblesë së zakonshme. Anëtarët e parë të saj janë caktuar në statut.

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të keshillit mbikqyrës që caktohen në statut është 3 vjet, ndërsa për ata që emërohen nga asambleja është 1 vit.


Anëtarët e keshillit mbikqyrës mund të rizgjidhen.

Ata mund të shkarkohen në çdo kohë nga asambleja e zakonshme.

I punësuari në shoqëri nuk mund të jetë anëtar i keshillit mbikqyrës të emëruar nga asambleja e aksionerëve.

NENI 33

Si anëtar i keshillit mbikqyrës mund të emërohet edhe një person juridik, i cili cakton një përfaqësues të përhershëm, që mban përgjegjësi civile e penale si anëtar i keshillit mbikqyrës.



NENI 34

Nuk mund të jetë anëtar një person fizik në më shumë se 8 këshilla mbikqyrës. Përfaqësuesit e personave juridikë nuk mund të jenë anëtarë në më shumë se 5 këshilla mbikqyrës.

Nëpunësit e administratës shtetërore nuk mund të jenë anëtarë në më shumë se tre këshilla mbikqyrës.

NENI 35

1/3 e këshillit mbikqyrës mund të zgjidhen nga të punësuarit ne shoqëri. Kur ky numër është më i madh se dy, kuadrot dhe personat që barazohen me ta, kanë të paktën një vend në këshillin mbikqyrës

NENI 36

Të punësuarit zgjidhen anëtarë të këshillit mbikqyrës me votim të fshehtë të të gjithë të punësuarve në shoqëri, të cilët kanë lidhur kontratën e punës mbi tre muaj përpara datës së zgjedhjes.

Zgjedhjet bëhen me votim maxhoritar me dy ture, ose me lista propocionale.

Në rast barazimi votash kandidati që ka kontratën më të vjetër të punës konsiderohet fitues.

NENI 37

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të zgjedhur nga të punësuarit është 1 vit. Mandati është i përsëritshëm.

NENI 38

Prishja e kontratës së punës i jep fund mandatit të anëtarit të këshillit mbikqyrës të zgjedhur nga të punësuarit.

Anëtarët e zgjedhur nga të punësuarit mund të shkarkohen vetëm për faje në ushtrimin e mandatit të tyre dhe me vendim të asamblesë që mblidhet urgjentisht me kërkesën e shumicës së anëtarëve të këshillit mbikqyrës. Vendimi ekzekutohet përkohësisht deri sa të marrë formë të prerë.

NENI 39

Kontrata e punës e një anëtari të këshillit mbikqyrës të zgjedhur nga të punësuarit shpallet e prishur vetëm nga gjykata, me përjashtim të rastit kur kjo prishje bëhet me iniciativën e tij.

NENI 40

Vendi bosh i një anëtari të këshillit mbikqyrës të zgjedhur nga të punësuarit plotësohet:

-nga zëvendësuesi, kur zgjedhja është bërë maxhoritare;


- nga numri rendor i mëpasëm i listës, kur zgjedhja është bërë propocionale.

NENI 41

Këshilli mbikqyrës zgjedh nga gjiri i tij një kryetar dhe një zëvendës kryetar.

Nëqoftëse kryetari ose zv.kryetari lirohet nga detyra para mbarimit të afatit, do të kryhet një zgjedhje tjetër për periudhën e mbetur nga koha e ushtrimit të detyrës së personave që janë liruar.

Në pamundësi zgjedhje të kryetarit dhe zëvendësit të tij, gjatë kësaj kohe detyrat do të kryhen nga anëtari më i vjetër i këshillit mbikqyrës.



Këshilli mbikqyrës mund të përcaktojë rregulla të brendshme lidhur me procedurën e punës. Megjithatë vendimet nxirren vetëm nga këshilli mbikqyrës pa votë vendimore.

NENI 42

Këshilli mbikqyrës merr vendime të vlefshme kur janë të pranishëm 1/2 e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm ose përfaqësuesve të tyre.

Vota e kryetarit është përcaktuese në rast se rezultati i votimit është i barabartë.

NENI 43

Asambleja mund t'u caktojë anëtarëve të këshillit mbikqyrës si shpërblim një shumë vjetore fikse për pjesëmarrjen e tyre në seancat e këtij këshilli.

Kjo pagesë do të jepet në fund të vitit financiar. Anëtarët e këshillit mbikqyrës kanë të drejtë të marrin edhe shpërblime të tjera me kryerjen e detyrës.

Këshilli mbikqyrës mund të caktojë shpërblime të jashtëzakonshme për shërbimet apo detyrat që u besohet anëtarëve të këshillit mbikqyrës.

NENI 44

Këshilli mbikqyrës ushtron kontroll të vazhdueshëm për administrimin e shoqërisë nga ana e saj.

Këshilli mbikqyrës ka të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimet dhe kontrollet që ai çmon të arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentat që ai gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

Drejtorja i paraqet raport këshillit mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj.

Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar drejtorja i paraqit këshillit drejtues llogaritë vjetore dhe sipas rastit edhe llogaritë e konsoliduara.

Këshilli mbikqyrës i paraqet asamblesë vërejtjet e tij mbi raportin e drejtorisë si dhe mbi llogaritë e vitit financiar.

NENI 45

Mbledhja e këshillit drejtues thirret me shkrim nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zv. Kryetari. Lajmërimi bëhet 15 ditë përpara. Në raste urgjente lajmërimi mund të bëhet brenda një kohe më të shkurtër dhe ftesa mund të komunikohet gojarisht, me telefon, me teleks ose telegram. Në ftesë duhet të përcaktohet rendi i ditës dhe sugjeruesit e vendimeve.

Secili prej anëtarëve të këshillit mbikqyrës mund të shtrojë çështje në rendin e ditës, të cilat mund t'i bëhen të njohura kryetarit me anën e një letre të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes.

NENI 46

Anëtarët e këshillit drejtues duhet të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretet e shoqërisë, veçanërisht ato individuale dhe të biznesit, për të cilat ata janë bërë të vetëdijshëm nëpërmjet detyrës. Kjo mbetet e vlefshme edhe pas largimit nga këshilli mbikqyrës.

Nëqoftëse palët e tjera kanë marrë pjesë në mbledhjen e këshillit mbikqyrës, ato gjithashtu duhet të ruajnë maturinë.



NENI 47

Shoqëria mund të caktojë eksperte kontabël për çdo vit financiar, të cilët emërtohen nga asambleja e zakonshme.

Ekspert i parë kontabël është Zoti Kristaq Çombi, eksperte kontabël e miratuar. Asambleja e zakonshme emëron edhe zëvendës ekspert kontabël.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmërinë e tyre.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmërinë e tyre.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për dëmet që i shkaktojnë shoqërisë nga pasaktësia e mbajtjes së llogarive dhe nga verifikimi i gabuar i tyre.

Themeluesit, anëtarët e drejtorisë dhe të këshillit mbikqyrës, personat e afërt gjini të tyre deri në shkallën e katërt të gjinisë e krushqisë, bashkëshortet e tyre, drejtuesit e filialeve dhe të zyrave nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertëve kontabël apo zëvendës ekspert kontabël.

NENI 48

Eksperti kontabël ka këto detyra:

- garanton që llogaritë vjetore janë të rregullta;
- përshtatjen e kontabilitetit me legjislacionin në fuqi;
- përputhja e informacioneve të dhëna në raportin e administrimit me llogari vjetore.

BILANCI

-FITIMI NETO I SHOQËRISË-

NENI 49

